

**Letër e hapur
Kryetarit të Komunës së Klinës z. Sokol Bashota**

I nderuari z. Bashota,

Fillimisht, dëshirojmë të jua urojmë mandatin e fituar, duke shpresuar që katër vitet e ardhshme do t'i shfrytëzoni për prosperitetin e komunës suaj dhe përmbushjen e premtimeve të dhëna, në bazë të të cilave qytetarët ju kanë dhënë besimin.

Instituti për Studime të Avancuara GAP në bashkëpunim me Rrjetin Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) kanë monitoruar aktivitetet dhe premtimet e juaja, të dhëna gjatë fushatës zgjedhore në periudhën 15 tetor – 14 nëntor 2009 dhe 7 – 12 dhjetor 2009. Si rezultat i monitorimit tonë të bërë në mediat e shkruara dhe elektronike, si dhe në dy debatet e juaja të mbajtura në "Jeta në Kosovë", ju keni premtuar:

- Investime në vlerë 50 milion euro;
- Investime në infrastrukturën rrugore, shkolla, shëndetësi dhe rini;
- Strehimin e familjeve të dëshmorëve, luftëtarëve, nevojtarëve dhe të gjithë atyre që janë në gjendje të rëndë sociale;
- Ngritjen e një objekti banimi enkas për familjet e dëshmorëve, invalidët, dhe veteranët e luftës;
- Pajisjen e QMF-së me internet dhe sigurimin e të dhënave në mënyrë elektronike të cilat do të përdoren për histori për çdo pacient;
- Ndërtimin e Shtëpisë së re të Kulturës në vendin ku ndodhet e vjetra, e cila do t'i ketë 420 ulëse, dhoma përcjellëse, dhe bibliotekë me 50 ulëse (brenda vitit 2010);
- Ndërtimin e stacioni të autobusëve tek stacioni i trenit;
- Mbështetjen e futbollit, boksit, hendbollit dhe sporteve të tjera;
- Rregullimin e palestrës sportive;
- Ndërtimin e një shkolle të mesme në vlerë rreth 2 milion euro;
- Funksionimin e impiantit i cili do të furnizoj me ujë të pijshëm 16 fshatra verilindore të komunës së Klinës;
- Ndërtimin e rrjetit të kanalizimit në të gjitha fshatrat;
- Vazhdimin e kanalizimit dhe rrugëve të fshatit Gremnikë;
- Trotuarin Gremnikë-Qypevë në aksin rrugorë Klinë-Gjakovë, nëpër të cilin udhëtojnë nxënësit e Qypevës për shkollën e Gremnikut;
- Ndërtimin e rrjetit të kanalizimit dhe ujësjellësit në fshatin Zajm, si dhe asfaltimin e rrugës së këtij fshati, e cila lidhet me magjistralen Pejë-Prishtinë;
- Lidhjen e fshatrave Gllarevë, Zabërgjë, Cerovik, dhe Cabiqi në ujësjellës;
- Ndërtimin e objektit modern të ambulancës dhe asfaltimin e rrugëve në fshatin Gllarevë;
- Ujësjellësin për fshatin Jelloc dhe fshatrat e tjera të Bashkësisë Lokale të Jashanicës;
- Investimet me vlerë prej 2.5 milionë euro për rregullimin e çështjes së ujit të pijshëm;
- Trefshimin e projekteve për lokalitetin e Jellocit;
- Investimet në kanalizim, ujësjellës dhe rrugë të fshatrave Cerovik dhe Siqevë;

- Asfaltimin e rrugëve dhe kanalizimin në fshatin Sferkë;
- Ndërtimin e rrugës transitore afër fshatrave Dollc e Dresnikë;

Për fund, ju bëjmë me dije se Instituti GAP dhe BIRN, në fund të çdo viti kalendarik, do të dalin me raporte vlerësuese rreth përmbushjes së premtimeve të dhëna nga kryetarët e komunave.

Ju urojmë qeverisje të suksesshme dhe shpresojmë në bashkëpunimin tuaj edhe në të ardhmen.

Sinqerisht,

Instituti për Studime të Avancuara GAP
Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN)